



MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë Zgjedhjet presidenciale dhe lokale, Rrethi i parë – 22 mars 2009

DEKLARATA PËR REZULTATET DHE KONKLUDIMET PRELIMINARE

Shkup, 23 mars 2009 – Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ) për zgjedhjet presidenciale dhe lokale të 22 marsit 2009 në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë paraqet veprim të përbashkët mes Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut pranë OSBE-së (OSCE/ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP OSBE) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), e cila vëzhgon vetëm zgjedhjet presidenciale, ndërsa Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) vëzhgon vetëm zgjedhjet lokale.

Procesi zgjedhor vlerësohet nga aspekti i përmbushjes të përkushtimeve dhe standardeve të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike, si dhe të legjislativës vendore. Deklarata për rezultatet dhe përfundimet preliminare përpilohet para përfundimit të procesit. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë përpunimin dhe paraqitjen tabelare të votave, dhe shpalljen e rezultateve, trajtimin e ankesave dhe parashtrësive të mundshme pas zgjedhjeve, dhe mbajtjen e rrethit të dytë të zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të përpilojë dhe shpall një raport të plotë përfundimtar, duke përfshirë edhe rekomandime për përmirësime të mundshme, afërsisht dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. Delegacioni i APKE do të paraqes raportin e tij në seancën e ardhshme të Asamblesë në prill të vitit 2009. Kongresi do të elaborojë raportin e tij në komitetin e përhershëm në qershor të vitit 2009.

Institucionet e përfaqësuara në kuadër të MNVZ i falënderojnë autoritetet dhe qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për bashkëpunimin e tyre, dhe qëndrojnë të gatshme që t'i mbështesin ata si dhe shoqërinë civile të vendit, në mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.

PËRFUNDIME PRELIMINARE

Rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale dhe lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë më 22 Mars 2009 kanë përmbushur shumicën e përkushtimeve dhe standardeve të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike si dhe shumicën e kushteve dhe kërkesave të legjisllacionit vendor, edhe pse disa sfida ngelin edhe më tej. Zgjedhjet u administruan në mënyrë të mirë dhe pa incidente të dhunshme që njollosën zgjedhjet parlamentare të vitit të kaluar. Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe procesi i votimit në përgjithësi u menaxhua në mënyrë të mirë, edhe pse pati parregullësi procedurale dhe procesi i numërimit të votave u vlerësua si më pak pozitiv.

Autoritetet dhe liderët e partive politike bënë përpjekje të përbashkëta për të siguruar që zgjedhjet të mbahen në atmosferë të qetë. Pjesëmarrësit vazhdimisht dhe publikisht kanë deklaruar përkushtimin e tyre për zgjedhje paqësore dhe demokratike. Fjalori i përdorur gjatë fushatës në shumë raste ishte i qetë dhe i matur, ndërsa partitë dhe kandidatët u përpoqën të zvogëlojnë tensionet politike përmes nënshkrimit të kodeve të mirësjelljes, takimeve mes liderëve partiak dhe kandidatëve, dhe në përgjithësi me një sjellje të përgjegjshme.

Ambienti i mosbesimit i vërejtur deri diku në zgjedhjet e kaluara, vazhdoi edhe më tej, gjë që u dëshmuua nga pohime të shumta shqetësuese për shtypje ose frikësime të qytetarëve në lidhje me zgjedhjet, veçanërisht të punonjësve të shërbimit publik në mbarë vendin gjatë periudhës

parazgjedhore. Në fund të fushatës, autoritetet u morën me këtë çështje por me mënyrën se si vepruan, nuk arritën ta tejkalojnë mungesën e besimit.

Zgjedhjet u paraprinë nga një fushatë e shkurtër por shumë intensive dhe e theksuar, me tubime të shumta publike dhe një numër të madh kandidatë komunash dhe partish që ofruan një zgjedhje të vërtetë për votuesit. Shumica e partive dhe kandidatëve zhvilluan fushatat e tyre kryesisht (shpeshherë ekskluzivisht) para bashkësive të tyre etnike, që u reflekton ndarjet etnike në vend. Femrat ishin në numër të vogël në tubimet partiake dhe ato kanë poste të pakta vendimmarrëse në partitë politike.

Shumica i shohin zgjedhjet si mundësi kyçe për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë të avancojë drejt integritimeve Evropë-Atlantike, qëllim ky që synojnë të gjitha partitë më të mëdha politike.

Aspektet pozitive të procesit zgjedhor janë:

- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) i cili ka punuar në mënyrë të paanshme dhe transparente, përkundër mungesës të stafit të kualifikuar, dhe që ka gëzuar besimin mes kandidatëve dhe partive politike, gjithashtu edhe komisionet në nivelet më të ulëta që kanë punuar në përgjithësi mirë në periudhën parazgjedhore.
- Respekti i përgjithshëm i të drejtave të njeriut, siç janë liria e shprehjes dhe liria e tubimit, gjatë fushatës;
- Trupi i pavarur për rregullativë për mediat, Këshilli për Radiodifuzion, i cili punoi në mënyrë profesionale dhe efikase në pajtim me ligjin vendor;
- Një numër i madh i mediave elektronike nacionale dhe shtypi siguruan informim të gjerë dhe të llojllojshëm për votuesit— ndonëse jo gjithmonë i balancuar — përfshi këtu edhe tri debate televizive mes kandidatëve presidencial, me çka u mundësuan votuesve të bëjnë një zgjedhje të informuar;
- Kushti që së paku një person nga secila gjini të vendoset mes tre persona të radhitur në listën e kandidatëve të partive politike;
- Një numër i madh i vëzhguesve vendor dhe përfaqësuesve të partive dhe kandidatëve.

Çështjet shqetësuese janë:

- Dyshime për saktësinë e listës zgjedhore, veçanërisht sa i përket numrit të madh të qytetarëve që jetojnë jashtë dhe emrat e të cilëve ndoshta nuk janë regjistruar si të tillë;
- Rrjedhja e ngadalshme e proceseve gjyqësore kundër personave që kanë bërë shkelje të ligjit në zgjedhjet e vitit 2008 mund të pengoj përpjekjet për të pamundësuar vendosjen e një ambienti të mosndëshkimit që e kemi parë në zgjedhjet e kaluara;
- Mungesa e rregulloreve të detajuara zgjedhore për të siguruar praktika të qarta dhe konzistente dhe për të kompensuar paqartësinë e disa dispozitave nga Kodi Zgjedhor, i cili u ndryshua para ca kohësh;
- Mungesa e afateve për zgjedhjen e disa rasteve gjyqësore që kanë të bëjnë me zgjedhjet, me çka pengohet zbatimi i rregullave zgjedhore dhe mund t'ua mohojnë të drejtën pjesëmarrëse në zgjedhje për të pasur një mjet ligjor për ankesat e tyre, dhe
- Mungesë e kontrollit përkatës të dispozitave ligjore rreth financimit të fushatave, dhe boshllëqe në ligj të cilat heqin kufijtë e donacioneve për fushatë;

Dita e votimit në përgjithësi ishte e qetë pa incidente të dhunshme apo të mëdha. KShZ vlerëson që 58 për qind e votuesve kanë dal në votime. Në përgjithësi vëzhguesit e MVZ-së kanë vlerësuar

procesin e votimit pozitivisht në 95 për qind të vendvotimeve të vizituara me dallime në rajone të ndryshme. Sidoqoftë, vëzhguesit kanë vërejtur një numër të parregullsive procedurale. Votimi familjar ishte vëzhguar si një prej problemeve, ashtu si dhe në zgjedhjet e kaluara. U raportuan vetëm raste të kufizuara të shkeljeve serioze, përfshirë edhe tre raste të mbushjes së kutive. Numërimi i votave është vlerësuar si më pak pozitiv me shume gabime të rëndësishme procedurale dhe disa shkelje serioze. Përpunimi tabelar në shumicën e KZK-ve është zbatuar në mënyrë të duhur dhe transparente, por në disa KZK procesi është vlerësuar si i disorganizuar dhe në një KZK numrat kanë qenë të manipuluar.

REZULTATE PRELIMINARE

Historiati

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është republikë parlamentare me pushtet ligjdhënës që përbëhet nga 120 deputet dhe pushtetin ekzekutiv të ushtruar nga Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri. Përveç si Komandant Suprem i Forcave të Armatosura dhe President i Këshillit për Sigurim, kompetencat e Presidentit janë edhe propozimi Parlamentit emrin e kandidatit për Kryeministër për votim, emërimi ambasadorëve, propozimi i gjykatës, dhe dekreti i ligjeve. Presidenti i tashëm Branko Crvenkovski nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM), që është në këtë funksion vetëm një mandat, vendosi mos të kandidohet sërish.

Zgjedhjet presidenciale dhe lokale u shpallën më 10 janar 2009. Ato u mbajtën më 1 qershor 2008, për të cilat OSBE/ODIHR në raportin përfundimtar tha "në përgjithësi[...] nuk i plotësoi përkushtimet e OSBE-së, veçanërisht për shkak të dhunës dhe parregullsive. Pas këtyre zgjedhjeve, koalicioni zgjedhor i udhëhequr nga Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonase (VMRO-DPMNE) hyri në koalicion me partinë etnike shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partinë për Ardhmërinë Evropiane (PEI); koalicioni në Parlament ka mazhorancën prej 82 deputet.

Sistemi Zgjedhor dhe Korniza Zgjedhore

Korniza ligjore për zgjedhjet presidenciale dhe lokale është konsoliduar brenda Kodit Zgjedhor gjithëpërfshirës që u soll në vitin 2006. Në tetor të vitit 2008, Parlamenti solli disa amendamente të Kodit, pjesë e të cilave ishin rezultat i rekomandimeve të OSBE/ODIHR dhe Komisionit Venecian i Këshillit të Evropës. Megjithatë, disa nga këto rekomandime nuk u zbatuan apo u zbatuan pjesërisht. Për shembull, rregulloret për financimin e fushatave u përmirësuan por mungojnë akoma mekanizma për zbatimin apo kontrollin e tyre, si dhe kufizim të donacioneve në mallra dhe shërbime. Në përgjithësi, Kodi Zgjedhor edhe më tej ka dispozita të paqarta dhe të padetajuara, që lë hapësirë për interpretime të kundërta ose procedura inkonzistente, veçanërisht në mungesë të një rregulloreje të qartë dhe të detajuar.

Presidenti zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt për një mandat pesëvjeçar dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë. Që të zgjidhet që në rrethin e parë, kandidati duhet të fitoj shumicën absolute të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar. Kjo dispozitë e bën tejet të vështirë që kandidati të zgjidhet në rrethin e parë. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e plotëson këtë kusht, atëherë dy kandidatët e parë kalojnë në raundin e dytë që mbahet pas 14 ditë. Zgjidhet kandidati i cili fiton më shumë vota në rrethin e dytë, me kusht që në zgjedhje të kenë dalë së paku 40 për qind të votuesve. Ndryshe, i gjithë procesi zgjedhor duhet të përsëritet.

Zgjedhjet lokale u zhvilluan në 84 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Këshilltarët komunal zgjedhen me sistemin proporcional me lista të mbyllura, dhe nuk varen nga përqindja e pjesëmarrjes. Kandidati për kryetar komune zgjedhet nëse në rrethin e parë fiton mbi 50 për qind të votave, me

kusht një e treta e votuesve të regjistruar në atë komunë të kenë dalë në votim. Nëse nuk ka fitues në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë pas dy javësh mes dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave, pavarësisht nga pjesëmarrja.

Administrimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet presidenciale dhe lokale të vitit 2009 u administruan nga një administratë zgjedhore e trefishtë, që përfshin Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KShZ), 84 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), Komisionin e Zgjedhjeve të Qytetit të Shkupit, dhe 2,976 Këshilla të Zgjedhjeve (KZ). KShZ-ja në përbërjen aktuale është emëruar nga Parlamenti më 4 dhjetor 2008, pak më shumë se një muaj para shpalljes të zgjedhjeve. Në pajtim me amendamentet e reja të Kodit Zgjedhor, kryetari i KShZ-së dhe dy anëtarë u propozuan nga opozita, dhe zëvendësi dhe tre anëtarë nga partitë në qeveri.

Anëtarët e KKZ-ve dhe shumica e anëtarëve të KZ-ve dhe zëvendësit e tyre u zgjedhën në mënyrë të rastësishme me kompjuter mes nëpunësve të administratës shtetërore, komunale dhe publike. Ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, përbërja e KZ-ve u transformua në një model të përzier profesional dhe politik me një anëtarë (dhe zëvendës) nga çdo KZ i emëruar nga partitë politike në opozitë dhe një anëtarë (dhe zëvendës) i emëruar nga partitë në pushtet. Kjo duket se ka rritur besimin e partive më të mëdha politike ndaj administratës zgjedhore, dhe ka lehtësuar procesin e angazhimit të numrit të madh të anëtarëve të KZ-ve (që arrin 30,000 së bashku me zëvendësit) vetëm nga administrata.

Në përgjithësi, përgatitjet për zgjedhjet u zhvilluan pa pengesa dhe në kohë, megjithëse KShZ-ja kishte vështirësi gjatë punës për shkak të mungesës të stafit të kualifikuar të mjaftueshëm - çështje kjo që u theksua edhe në raportet e kaluara të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës. KShZ-ja ka punuar në mënyrë transparente dhe me frymë konsensusi. Gëzonte besimin e shumicës të kandidatëve dhe partive politike.

KShZ ka adoptuar një Doracak për edukimin e organeve zgjedhore. Megjithatë, Doracaku nuk elaboron procedurat zgjedhore në mënyrë praktike, dhe nuk përfshin udhëzime të detajuara rreth procedurave të përcaktimit të rezultateve dhe paraqitjes tabelar në nivel të KKZ-ve. KShZ-ja organizoi trajnim të detyrueshëm për KKZ-të dhe KZ-të, por zbatimin u shty përtej afatit.

KShZ-ja filloi një program të limituar për edukimin e zgjedhësve, dhjet ditë para zgjedhjeve, ku u përfshinë tre TV dhe radio stacione që kishte për qëllim motivimin e votuesve të marrin pjesë në votim, shpjegimin e procesit të votimit dhe paralajmërime kundër shkeljeve zgjedhore.

Regjistrimi i votuesve

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për mbajtjen dhe azhurnimin e listave zgjedhore. Lista zgjedhore u vu në dispozicion për verifikim publik nga 20 janari deri më 3 shkurt 2009. Gjithsej 195.323 qytetarë verifikuan të dhënat e tyre dhe u bënë 1.525 ndryshime. Lista zgjedhore u mbyll më 18 shkurt, me gjithsej 1.792.082 zgjedhës të regjistruar nga popullata e përgjithshme me 2.04 milion¹. Dy ekstrakte identike nga lista zgjedhore u përgatitën për çdo vendvotim, një për zgjedhjet presidenciale dhe një për zgjedhjet lokale.

Rreth 73,000 qytetarë të regjistruar që banojnë jashtë vendit janë përfshirë në listën zgjedhore, dhe janë shënuar me një yll. Megjithatë, shumë bashkëbisedues i thanë OSBE-ODIHR-së se besojnë se numri i qytetarëve që jetojnë jashtë është shumëfish më i madh. Rekomandimet e vazhduara të

¹ Të dhëna nga Regjistrimi i popullatës në vitin 2002 dhe të dhëna tjera janë në dispozicion në www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18

OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës se duhet bërë një kontroll të thelluar të listës zgjedhore mbeten për t'u realizuar.

Regjistrimi i kandidatëve

Shtatë kandidatura për president u dorëzuan dhe u konfirmuan nga KShZ-ja. Për zgjedhjet lokale, KKZ-të dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupi pranuan gjithsej 374 kandidatura për kryetar komune dhe 703 lista kandidatësh për këshilltarë komunal; nga këto, 364 respektivisht 702 u konfirmuan. Procesi i grumbullimit të nënshkrimeve në mbështetje të kandidatëve është mjaft restriktiv dhe i vështirë, pasi që qytetarët mund të japin nënshkrimin vetëm për një kandidat dhe këtë ishin të detyruar ta bënin në zyrën rajonale të Ministrisë të Drejtësisë. Disa kandidatë apo kandidat të mundshëm u ankuan se sistemi ishte në disfavor të kandidatëve opozitar, pjesërisht sepse shumë qytetarë kanë pasur frikë të shkojnë në zyrën qeveritare për të regjistruar mbështetjen e tyre për kandidatin opozitar. Megjithatë në praktikë, kjo nuk pengoi regjistrimin e shumë kandidatëve presidencial dhe për kryetarë komune.

Ambienti i fushatës

Shtatë kandidatë garuan në zgjedhjet presidenciale: Imer Selmani (Demokracia e Re), Mirushe Hoxha (Partia Demokratike Shqiptare), Nano Ruzhin (Partia Liberal Demokrate), Gjorgje Ivanov (Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonase), Ljube Boshkoski (i pavarur), Agron Buxhaku (Bahskimi Demokratik për Integrim dhe Ljubomir Frçkoski (Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë). Vetëm dy nga gjashtë kandidatët të mbështetur nga partitë politike ishin anëtarë aktiv të partive që i propozuan. Rezultatete e pjesërishtme preliminare të dhëna nga KQZ-ja theksojnë se ... dhe ... do të garojnë në rrethin e dytë më 5 prill.

Fushata zyrtare zgjati vetëm 19 ditë, dhe atë prej 2-20 mars. Dispozitat ligjore në lidhje me aktivitetet që lejohen para fillimit të fushatës zyrtare janë të paqarta. MVZ i OSBE/ODIHR vëzhgoi disa raste të fushatave të parakohshme, por nuk u paraqitën ankesa formale për këtë dhe autoritetet nuk ndërmoren masa ndaj rasteve të fushatës të hershme që ndodhi pas hapjes të MVZ-së më 13 shkurt.

Gjatë fushatës zyrtare, partitë politike dhe kandidatët u filluan programe tubimesh shumë intensive. MVE i OSBE/ODIHR vëzhgoi mbi 100 tubime, ku liderët partiak, kandidatët për president dhe për kryetarë komunash, dhe për këshillat komunalë shpeshherë paraqiteshin së bashku. Dy raste të tubimeve të caktuara në kohë të njëjtë u zgjodhën në mënyrë paqësore. Tubimet u zhvilluan pa trazira dhe ishin kryesisht mjaft të vizituara, megjithëse kryesisht burra.

Fushata ishte shumë e dukshme mbarë vendit, duke përfshirë përdorimin e gjerë të tablove reklamuese dhe afisheve. Aktivistët e disa partive hoqën afisheet e kundërshtarëve të tyre, që rezultoi me disa incidente të vogla.

Një proces paqësor dhe demokratik konsiderohet si tregues tejet i rëndësishëm për avancimin e vendit drejt integritimeve Euro-Atlantike, qëllim ky që mbështet nga të gjitha partitë politike dhe që zë një vend të rëndësishëm në fushatat në nivel nacional. Gjatë gjithë procesit zgjedhor, kandidatët dhe partitë vazhdimisht kanë shprehur përkushtimin e tyre për zgjedhje demokratike dhe kanë premtuar se do t'u shmangen incidenteve të cilat kishin pasoja negative në zgjedhjet e vitit 2008. U nënshkruan kodet e sjelljes në nivel nacional dhe lokal, dhe në një rast ky veprim u shoqërua me një fushatë të gjerë për zgjedhje të drejta dhe demokratike. Megjithatë, një proces i mbarë zgjedhor shpeshherë dukej se barazohet me një ambient pa dhunë, pa i kushtuar vëmendjen e duhur elementeve të tjera thelbësorë për një proces zgjedhor demokratik.

Shumica e pjesëmarrësve në zgjedhjet presidenciale dhe lokale duket se po bëjnë përpjekje të qarta për të përdorur retorikë të qytetëruar dhe të matur në fushatë, megjithëse ka patur disa raste të ekcesive, siç ka qenë përdorimi i fjalorit nationalist apo që mund të shkaktojë ndarje në vija etnike. Disa takimet e liderëve të partive kryesore politike u mbajtën gjatë periudhës parazgjedhore, që patën për qëllim të promovojnë një qasje paqësore dhe bashkëpunim në zgjedhje. Në përpjekje për të promovuar një ambient të qytetëruar fushate, kandidatët presidencialë ndërmorën iniciativën për të mbledhur kundërshtarët së bashku në takime. Këto takime i dhanë mbështetje atmosferës të qetë para dhe gjatë ditës të zgjedhjeve. Megjithëse disa garues arritën t'i tejkalojnë barrierat etnik, shumica e partive dhe kandidatëve zhvilluan fushata kryesisht para bashkësive të tyre etnike ose, në shumë raste, vetëm para bashkësive të tyre, që pasqyrojnë ndarjet etnike.

MVZ i OSBE/ODIHR ka vërejtur tensionime në disa rajone, si për shembull në Gostivar, Dibër, Pillasnicë, Strumicë dhe në Shkup në komunën e Shuto Orizarit, ku kandidatët kanë shprehur akuza të rënda ndaj njëri-tjetrit. MVZ-ja u njoftua për disa incidente, kryesisht të vogla, që kishin të bëjnë me dëme të zyrave partiake, raste të rrahjeve mes aktivistëve politik, dhe kërcënime ndaj aktivistëve partiak, veçanërisht në rajonin e Gostivarit. Ministria e Brendshme ngriti disa aktpadi për kundërvajtje si përgjigje ndaj këtyre incidenteve.

Gjatë periudhës parazgjedhore MVZ i OSBE/ODIHR pranuan ankesa të shumta dhe shqetësuese për shtypje apo frikësime të qytetarëve në lidhje me zgjedhjet, mbarë vendit. EOM ka hetuar këto ankesa dhe disa nga to i ka konfirmuar si të besueshme. Bashkëbiseduesit kanë pohuar se punonjësit në sektorin publik, të cilët thuhet se janë punësuar falë motiveve politike, kanë qenë ata që kanë rënë pre e presioneve nga partitë në pushtetin qendror dhe atë lokal. Ka gjithashtu ankesa për shtypje mbi pensionistët, si dhe raportime për pronarë të bizneseve të cilët iu bëjnë shtypje punëtorëve të tyre apo ata vetë janë nën presion nga kërcënimet për kontrole nga inspektorët e tatimeve. Këshilli për Radiodifuzion njoftoi MVZ-në se ka qenë nën presion nga Qeveria të ndryshojë rezultatet, gjë që Këshilli nuk ka pranuar ta bëj.

Në ditët e fundit para ditës të zgjedhjeve, Kryeministri dha disa deklaratat publike dhe njoftoi zyrtarët publik se aktivitetet të tilla nuk do të tolerohen. Megjithatë, këto pohime ishin të shumta dhe duket se pjesa dërmuese e popullatës iu besoi. Kjo tregoi se atmosfera e mosbesimit që rezultoi nga tensionimet dhe frikësimet e vëzhguara në zgjedhjet e mëparshme vazhduan deri diku edhe në këto zgjedhje. Përgjigja e Qeverisë pra ishte e pamjaftueshme për t'i plotësuar detyrimet e saj për të zbatuar zgjedhje pa frikësime ose pa frikë nga ndëshkimet.

Para shpalljes të zgjedhjeve, Qeveria u angazhua në një fushatë publicitare të shtrenjtë në mbështetje të politikave dhe programeve të veta. Megjithëse ato u ndërpre në kur u shpallën zgjedhjet, partitë opozitare dhe përfaqësuesit e mediave thonë se këto fushata ishin kaq të gjera dhe agresive që vazhdojnë të kenë ndikimin e tyre mbi fushatën zgjedhore dhe kanë bërë që shumë nga mediat të varen nga të ardhurat nga reklamat qeveritare.

Që nga shpallja e zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror kundër Korrupsionit në vazhdimësi i ka përkujtuar organet shtetërore dhe lokale t'u shmangen investimeve dhe kontratave të reja, punësimeve të reja, apo përdorimit të fondeve publike dhe pagesave të jashtëzakonshme gjatë periudhës zgjedhore, siç parashihet me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit. Komisioni njoftoi Zyrën e Prokurorit Publik në lidhje me dy raste të akuzave për blerje votash dhe vendosi që të shqyrtonte një ankesë të paraqitur nga Partia e Re Social Demokrate (PRSD) për shpërdorimin e burimeve nga Qeveria.

Ministria e Punëve të Brendshme hartoi një plan të përgjithshëm për vendosjen e policisë në ditën e zgjedhjeve, siguroi trajnim për gjithë policët që do të caktohen për zgjedhjet dhe vendosi disa

procedura të reja, duke përfshirë këtu edhe kushtin që secili polic të mbajë shenjë identifikimi, ditën e zgjedhjeve.

Ndjekja dhe rastet gjyqësor kundër personave që janë akuzuar për shkelje penale gjatë zgjedhjeve të vitit 2008 kanë vazhduar edhe në periudhën parazgjedhore. Megjithatë, procedurat e ngadalshme mund të pengojnë përpjekjet për të ndryshuar ambientin e mosndëshkimit që është parë në zgjedhjet e mëparshme². Liderët e dy partive opozitare i kanë thënë MVZ-së të OSBE/ODIHR se besojnë se rastet trajtohen varësisht nga përkatësia politike e të akuzuarve. Kjo akuzë u mbështet nga të tjerët, siç janë grupet joqeveritare, por u mohua nga Qeveria. Bashkëbiseduesit gjithashtu kanë theksuar se një nga pengesat kryesore në procesimin e disa rasteve është se vetë dëshmitarët frikohen të dëshmojnë apo të mbajnë dëshmitë e tyre paraprake.

Pjesëmarrja e grave

Mirushe Hoxha ishte e vetmja kandidatë femër në garën presidenciale dhe është femra e parë në vend që është kandiduar për President. Vetëm 14 femra garojnë për kryetar komune, në 11 komuna (nga 3,8 për qind nga 364 kandidatë). Neni 64 i Kodit Zgjedhor, që thotë se në listat e kandidatëve për këshillat komunalë dhe në zgjedhjet parlamentare nga tre kandidatë duhet të ketë një përfaqësues nga "gjinia më pak e përfaqësuar", u zbatua në mënyrë të duhur; në disa raste, gratë janë të pranishme në numër më të madh se numri minimal i paraparë.

Megjithëse neni 64 çoi deri në rritjen e pjesëmarrjes të femrave në politikë, ato megjithatë mbeten të pakta në pozitat udhëheqëse të partive politike dhe në qeveri. Femrat nuk janë aktive në politikë sa burrat, dhe kjo shihet edhe në numrin e vogël të grave që dalin në tubimet partiake. Partitë politike duket se nuk kanë bërë përpjekje të veçanta për të tërhequr votat e femrave. Tridhjetë e tre gra janë aktualisht deputete në Parlament (32,7), tri janë kryetare komune (3,5 për qind), dhe 309 janë anëtare të këshillave komunalë (21,7 për qind).

Sipas ligjit organet zgjedhore duhet në përbërjen e tyre të kenë së paku 30% nga secila gjini. Kjo dispozitë respektohet në nivel të KKZ-ve ndërsa KShZ-ja ka njoftuar MVZ-në e OSBE/ODIHR-së se KZ-të gjithashtu e kanë plotësuar këtë kusht. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në vendvotimet e vizituara, mes anëtarëve të KZ-ve 46 për qind ishin gra dhe prej tyre kryetare ishin në 44 për qind të KB-ve. Megjithatë, Parlamenti nuk plotësoi kushtin për barazi gjinore gjatë emërimit të anëtarëve të KShZ-së, pasi që vetëm një nga shtatë anëtarët është femër. Përkundër fushatave të organizatave të shumta nacionale dhe ndërkombëtare, përfshi edhe KShZ-në, me qëllim të zmadhimit të pjesëmarrjes të femrave dhe ndalimit të votimit familiar dhe votimit për tjetër, praktika të tilla u vërejtën nga vëzhguesit e MNVZ-së si dhe në zgjedhjet e mëparshme.

Pjesëmarrja e minoriteteve nacionale

Afro 33 kandidat për kryetar komune i takojnë komuniteteve etnike që nuk janë Maqedonas etnik apo Shqiptarë etnik. Dy të tretat e tyre u takojnë partive që përfaqësojnë grupet etnike të tyre. Në përgjithësi, ndikimi politik i komuniteteve etnik është rritur falë decentralizimit dhe rritjes të kompetencave të komunave. Kushtet ligjore për përfaqësim "adekuat dhe të drejt" të komuniteteve etnike në administratën zgjedhore janë plotësuar. Në praktikë, zbatimi i dispozitave ligjore ishte në dëm të komuniteteve etnike më të vogla.

Në nivel nacional, shumica e partive politike që përfaqësojnë komunitetet e vogla etnike janë në koalicion me partinë qeverisëse VMRO-DPMNE dhe mbështesin kandidatin e koalicionit për president. Në nivel lokal, janë bërë përzjerje komplekse koalicionesh dhe këmbimesh, ku partitë e

² Numri i individëve të dënuar për shkelje penale është 32 nga 200 aktpadi të ngritura. 76 presin gjykimin, ndërsa 14 akuza janë hedhur poshtë

komuniteteve etnike firmosën marrëveshje parazgjedhore kryesisht me VMRO-DPMNE apo me partnerin e tij shqiptar BDI-në. Mbështetja më e madhe ka të bëj me premtimet për të vepruar në lidhje me çështjet lokale. Ka pasur raportime të vazhdueshme për frikësime dhe përpjekje për blerje të votave nga pjesëtarët e komuniteteve që nuk i gëzojnë të drejtat civile, veçanërisht Romët. Organizatat rome vazhdojnë të ngrenë këtë çështje në fushatat për rritjen e vetëdijes.

Mediat

Ka një peizazh të llojlojshëm të mediave që përbëhet prej 150 TV dhe radio stacioneve dhe shumë media të shtypit, të cilët garojnë në një treg reklamimi të kufizuar. TV kanalet nacionale private sundojnë në treg dhe televizioni është mediumi dhe burimi kryesor i informimit politik.

Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Radiodifuzion formojnë kornizën ligjore që shërben si bazë sipas të cilës udhëhiqen mediat gjatë fushatës. Këshilli për radiodifuzion (KR), organ që mbikëqyr mediat, ka punuar në mënyrë ta pavarur, profesionale dhe efikase; KR-ja adoptoi rregullore për periudhën zyrtare të fushatës, sipas të cilës mediat elektronike duhet t'i kushtojnë kohë të barabartë kandidatëve për president, ndërsa koha për kandidatët për kryetar komune nga mediat nacionale duhet të jetë proporcionale me numrin e kandidatëve për kryetar komune dhe këshilltarët nga çdo parti. Përderisa këto kanë për qëllim të sigurojnë raportim të balancuar nga fushata, ato janë deri diku në kundërshtim me idenë e lirisë të redaksisë. Sipas udhëzimeve të Këshillit për Radiodifuzionin (KR) për periudhën që i paraprin fushatës, mediat mundeshin të paraqesin aktivitete zgjedhore vetëm në lajmet e tyre, dhe nuk iu lejohej të emitojnë përmbajtje të tjera në lidhje me zgjedhjet, si për shembull, intervista me kandidatët dhe liderët politik.

Mediat elektorinike në përgjithësi i respektuan këto udhëzime, veçanërisht pasi që KR lëshoi paralajmërime dhe ngriti padi për kundërvajtje kundër mediave elektroine. Gjatë fushatës zyrtare, KR lëshoi disa paralajmërime duke i kujtuar mediat se duhet të respektojnë dispozitat ligjore dhe ngriti aktpadi kundër katër emetuesve. KR-ja gjithashtu ngriti aktpadi kundër tre mediave elektronike për shkeljen e periudhës të heshtjes zgjedhore. Megjithëse masat e ndërmarra nga KR u kritikuan ashpër nga mediat, vendimet e tij ishin të arsyeshme dhe me bazë, në pajtim me ligjin e vendit. Në përgjithësi, KR zbatoi udhëzimet dhe rregulloret e tij në mënyrë objektive dhe të mirëfilltë.

Që nga 16 shkurti, MVZ i OSBE/ODIHR zhvilloi analiza kuantitative dhe cilësore të kohës kryesore të emetimit të dy televizioneve publike, MTV1 dhe MTV2, dhe katër TV kanaleve private – A1, Alsat-M, Kanal 5 dhe Sitel, si dhe lajmet e mbrëmjes të TV Alfa. Përmbajtja e pesë gazetave ditore, *Dnevnik*, *Koha*, *Lajm*, *Nova Makedonija* dhe *Vreme*, gjithashtu ishin objekt vëzhgimi. Veç kësaj, MVZ zhvilloi vëzhgim afatshkurt mbi disa televizione lokale dhe nacionale për të vlerësuar mbulimin e fushatës.

Në përgjithësi, mediat elektronike dhe shtypi siguruan informim të gjerë dhe të llojlojshëm për votuesit, me çka iu mundësua të bëjnë një zgjedhje të informuar. Tre debatet televizive dhe dy debatet në radio me të gjithë kandidatët për president u mundësuan votuesve të bëjnë krahasimin mes tyre.

Televizioni publik secilit kandidat për president i dha 70 minuta kohë falas, dhe të gjithë kandidatët për kryetar komune kishin mundësinë të shfrytëzojnë tre minuta kohë falas. Më tej, televizioni publik emitoi programe zgjedhore kushtuar kandidatëve për kryetar të qytetit të Shkupit dhe kandidatëve që garojnë në komunat të banuara me shumicë Shqiptarë etnik. Megjithatë, të dy kanalet e MTV-së kanë emituar shpesh lajme për projekte dhe iniciativa qeveritare që reflektonin mbështetjen për Qeverinë. Nga gjithë koha kushtuar aktorëve politik dhe pjesëmarrësve në zgjedhjet në programet e lajmeve të kanaleve televizive publike, afërsisht një e treta iu kushtua

Qeverisë. Përderisa MTV1 siguroi raportim të gjerë nga fushata, ky kanal nuk u dha kohë të barabartë të gjithë kandidatëve për president në programet informative. Megjithatë, kjo ishte, deri diku, rezultat i niveleve të ndryshme të fushatave nga partitë dhe kandidatët. Raportimi i MTV-2 i të gjithë kandidatëve për president në programet informative ishte më i balancuar, megjithëse jo i barabartë.

Mes televizioneve private, Alsat-M ofroi raportim të gjerë si për zgjedhjet presidenciale ashtu dhe për ato lokale. Raportimi i Alsat-M dhe Kanal 5 ishte i balancuar si nga aspekti i kohës ashtu dhe i tonit. TV A1 u kushtoi kohë mjaft të barabartë të gjithë kandidatëve për president;. Kanali privat Sitel dhe Alfa mbuluan kandidatët për president të LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së më shumë se kandidatët e tjerë. Siteli gjithashtu emitoi prezantime të zgjëruara të aktiviteteve të Qeverisë, me çka u rrit avantazhi i kandidatit të tyre.

Televizionet lokale dhe rajonale mbuluan informacionet në lidhje me zgjedhjet kryesisht në kuadër të lajmeve. Një numër TV kanalesh lokale emituan programe zgjedhore të veçanta, dhe disa nga to organizuan edhe debate. Në Gostivar, emetimi i debatit televiziv mes kandidatëve për kryetar komune u ndërpre për kohë të shkurtër, gjë që nxiti ankesa nga ana e kandidatit opozitar.

Gazetat e monitoruara siguruan pikëvështrime të ndryshme. Në përgjithësi, toni që është përdorur në gazeta rreth aktorëve politik ishte më kritik se në mediat elektronike. Gazetat *Dnevnik*, *Vreme dhe Nova Makedonija* përqendruan raportimin e tyre në kandidatët për kryetar që konsideroheshin si favorit në garën. Gazetat ditore në gjuhën shqipe *Koha* dhe *Lajmi* u dhanë hapësirë më të madhe partive etnike shqiptare, dhe portretimi i aktorëve politikë ndryshonte, të dy gazetat i dhanë kandidatit të partisë Demokracia e Re pothuajse gjysmën e gjithë kohës të paraparë për kandidatët presidencial, dhe paraqitej kryesisht në mënyrë pozitive.

Vetëm disa garues përdorën reklamat politika të paguara në masë të madhe, dhe fushata e VMRO-DPMNE-së mbizotëronte në të shumtën e mediave.

Ankesa dhe Apele

KShZ zgjedh ankesat nga kandidatët dhe zgjedhësit në lidhje me procedurat zgjedhore, duke përfshirë votimin, numërimin dhe paraqitjen tabelare. KShZ-ja ka adoptuar udhëzime se si duhet të zgjedh ankesat e parashtruara deri tek ai. Megjithatë disa aspekte procedurale rreth paraqitjes të ankesave nuk janë trajtuar mjaftueshëm dhe mbeten të paqarta. Apelet kundër vendimeve të Gjykatës Administrative mund të t'i paraqiten Gjykatës Administrative. Ankesat nga kandidatët dhe partitë në lidhje me të drejtat e tyre gjatë fushatës zyrtare paraqiten para Gjykatës të shkallës të parë, dhe vendimet e saj mund të apelojnë para Gjykatës të apelit.

KShZ dhe KR ngritën disa aktpadi për kundërvajtje për zhvillim të fushatës jashtë periudhës të paraparë për fushatë (shkelje e Nenit 74.2 nga Kodi Zgjedhor). Megjithatë, disa procese gjyqësore u shtynë pas ditës të zgjedhjeve. Prolongime të tilla në gjykatë në raste që kanë rëndësi kohore pengon zbatimin e rregullave zgjedhore dhe të drejtën e pjesëmarrësve në zgjedhjet për të pasur mjet ligjor efikas. Një numër i konsiderueshëm i kandidatëve dhe të tjerë i thanë MVZ-së të OSBE-ODIHR-së se nuk besojnë se gjykata vepron në mënyrë të pavarur gjatë zgjedhjes të ankesave.

Nuk u paraqitën ankesa në lidhje me regjistrimin e kandidatëve presidencialë. Gjykata administrative ka sjell, brenda afateve ligjore, 12 vendime për aktpadi për shkelje lidhur me regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet lokale. Gjykata pranoi katër aktpadi – me çka ktheu në garë kandidat të diskualifikuar nga KKZ-të - dhe refuzoi gjashtë, ndërsa dy u tërhoqën nga ankuesit. Pesë nga gjashtë aktpaditë u refuzuan për arsye procedurale, që tregon se disa kandidatë nuk i njohin të gjitha kërkesat procedurale.

Përkundër disa trajnimeve të organizuara për gjykatësit në gjykatat e shkallës të parë në lidhje me zbatimin e procedurave për mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve në pajtim me Nenin 73 të Kodit Zgjedhor, disa gjykata i kanë thënë MVZ të OSBE/ODIHR-së se një mbrojtje e tillë nuk është në kompetencat e tyre.

Vëzhguesit vendor

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgues të zgjedhjeve nga vendi dhe jashtë. Njëmbëdhjetë grupe të vëzhguesve jopartiak nga vendi akredituan në KShZ gjithsej 6.981 vëzhgues. Grupi më i madh vëzhgues ishte MOST-i, i cili akreditoi 4.520 vëzhgues. Most-i gjithashtu zhvilloi një paraqitje tabelare paralele për zgjedhjet presidenciale dhe për zgjedhjen e kryetarit të Qytetit të Shkupit dhe këshillit. Daja, organizatë rome e grave, akreditoi 212 vëzhgues mbarë vendit duke u përqendruar në komunat më shumicë Rome. Vëzhguesit e vendit ishin të pranishëm në 77 për qind të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ. Veç kësaj, partitë politike dhe kandidatët dërguan përfaqësues të autorizuar, të cilët ishin të pranishëm në 96 për qind të vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ në ditën e zgjedhjeve.

Dita e zgjedhjeve

Në përgjithësi dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore, pa ndonjë incident që përkujton zgjedhjet e vitit 2008. Vetem instanca të kufizuara të parregullesive zgjedhore janë vërejtur. Për shkak të kushteve të vështira klimatike, 134 vendvotime nuk u hapen, të cilat pamundësuan votimin e 12, 556 votuesve. Informatat preliminare të KQZ kanë treguar se numri i votuesve të dalë në zgjedhje arrinë në 58 për qind. KQZ-ja filloi me shpalljen e rezultateve në natën e votimeve dhe po ato i ka postuar në ëeb faqen e saj zyrtare, por jo në bazë të vendvotimeve, sikurse theksoi me parë se do ta bënte.

Vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ) vlerësuan ditën e herëshme të votimit me 21 mars si pozitive; temë kryesore ishte mungesa e shpeshtë e intimitetit për votuesit e palëvizshëm nga shtëpitë. Shumica e vëzhguesve të MNVZ kanë vlerësuar në përgjithësi hapjen e vendvotimeve si pozitive. Problemet pjesërisht janë theksuar në vulosjen e rregullt të kutive të fletvotimeve, në pjesë sepse disa vula të kutive nuk kanë funksionuar me rregull si dhe regjistrimi i numrit serik të vulave.

Vëzhguesit e MNVZ vlerësuan se procesin zgjedhor si të mirë ose si shumë të mirë në 95 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe të përshkruara si përgjithësisht mirë të organizuara, të qeta dhe në rregull. Sidoqoftë, vlerësimi dallon mes komunave krzesisht të banuara me shqipëtarë (8 për qind negative) dhe pjesës tjetër të vendit (3 për qind). Nuk janë regjistruar shprehje të dhunës ose incidente madhore, me tensionime vetem në disa vende. Puna e KZ gjatë votimit është vlerësuar si pozitive në 91 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe të kuptuarit e procedurave në 93 për qind. Në disa raste prezenca e më tepër se një përfaqësuesi të një partie politike mund të kenë rënduar atmosferën në vendvotime. Policia është parë jashtë vendvotimeve në 66 për qind të rasteve dhe në përgjithësi është vlerësuar si mirë e organizuar dhe diskrete.

Edhe përkundër vlerësimeve të tyre përgjithësisht pozitive, vëzhguesit e MNVZ vunë re një sërë parregullsish procedurale gjatë procesit të votimit. Votimi familjar është vërejtur si një problem, e veçanërisht në komunat kryesisht të banuara me shqiptar, si dhe në zgjedhjet e kaluara. Problemet tjera janë: votimi për dikë tjetër (33 raste), personi i njejtë “të ndihmojë” një numër më të madh votuesish (41 raste), tentime për të ndikuar votuesit (46 raste), kërcnim dhe frikësim të autoriteteve zgjedhore dhe votuesve (tetë raste), një sërë nënshkrimesh dukshëm identik në listën e votuesve (19

raste) dhe votim të shumëfishtë (shtatë raste). Në 5 për qind të vendvotimeve të vizituara, kutitë e votimit nuk ishin të mbyllura në mënyrë të duhur. Vëzhguesit e MNVZ raportuan tri raste të mbushjes së kutive në Strumicë dhe Tetovë. Në 10 për qind të vendvotimeve të vizituara fshehtësia e votës nuk është respektuar, kryesisht për shkak të vendosjes së dobët të kabinave, kufizimit hapsinor ose tollovisë së madhe në vendvotim; janë raportuar vetëm disa raste ku njerëzit kanë fotografuar fletëvotimet e shënuara. Në përgjithësi procedurat e ngjyrosjes së gishtit janë aplikuar. Persona të paautorizuar janë parë në 3 për qind të vendvotimeve të vizituara; në pesë raste ata kanë ndërhyrë apo kanë udhëhequr procesin.

Sidoqoftë, numërimi i votave është vlerësuar negativisht në 14 për qind të vendvotimeve të vizituara. Procedurat themelore shpesh herë nuk janë ndjekur, përfshirë përputhjen e numrave. Një nga pesë vëzhgues të MVZ-së kanë raportuar për gabime të rëndësishme procedurale. Gjysma e këshillave zgjedhore nga vendet ku është vëzhguar numërimi i votave, nuk kanë dorëzuar kopje të protokollit të rezultateve për informim publik, siç kërkohet.

Vëzhguesit e MVZ-së kanë përcjellur përpunimin dhe paraqitjen tabelare të rezultateve në 41 nga 84 KZK dhe kanë vlerësuar pozitivisht procesin në të gjitha, pos në 4 KZK. Në shumicën e KZK-ve procesi u zbatua në mënyrë të duhur dhe transparente. Shpesh herë vetëm vëzhguesit e MVZ-së janë lejuar të vëzhgojnë digjitalizimin e të dhënave, dhe në disa KZK procesi është vlerësuar si i paorganizuar. Në Shuto Orizarë vëzhguesit e MVZ-së kanë raportuar se KZK-të kanë manipuluar numrat me qëllim që të arrihet përpueshmëri e të dhënave. Në Demir Hisar vëzhguesit e MVZ-së janë kërkuar nga Kryetari i KZK-së të lëshojnë objektin.

***Kjo deklaratë është në dispozicion edhe në maqedonisht dhe shqip.
Megjithatë, versioni anglisht mbetet i vetmi dokument zyrtar.***

INFORMATA DHE MIRNJOHJE TË MISIONIT

Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR u hap më 13 shkurt me 39 ekspert dhe vëzhgues afatgjatë të dislokuar në Shkup dhe në 11 qendra rajonale. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) zhvilloi një vizitë parazgjedhore prej 26-27 shkurt 2009. Në ditën e zgjedhjeve, rreth 320 vëzhgues të përkohshëm u vendosën në kuadër të një Misioni Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ), përfshi këtu edhe një delegacion 18-anëtarësh nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP OSBE) dhe një delegacion 14-anëtarësh të APKE-së, dhe një delegacion 13-anëtarësh i Delegacionit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Vëzhgues kishte nga gjithsej 40 vende pjesëmarrëse të OSBE-së. MNVZ vëzhgoi votimin në më se 1,500 vendvotime nga 2,976 dhe numërimin e votave në 150 vendvotime. MNVZ vëzhgoi procesin e paraqitjes tabelare në 73 KZK.

Znj. Pia Christmas-Møller (Danimarkë), nënkryetare e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Shefe e delegacionit të AP të OSBE-së, u emërua nga Kryesuesi i OSBE-së si koordinatorë speciale për të udhëhequr misionet vëzhguese afatshkurtër të OSBE-së. Znj. Marietta de Pourbaix-Lundin (Suedi) udhëhoqi delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, dhe Znj. Ludmila Sfirloaga (Rumuni) udhëhoqi delegacionin e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Z. Peter Eicher (SHBA) është Shefi i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-së.

IEOM dëshiron të falënderojë Ministrinë e Jashtme për ftesën të vëzhgojë zgjedhjet, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe për dhënien e akreditimeve, dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe autoriteteve të tjera shtetërore dhe lokale për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. MNVZ-ja gjithashtu dëshiron të shpreh falënderimin e tij Misionit të OSBE në Shkup dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Për informata më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni:

Z. Peter Eicher, Shefi i MVZ-së të OSBE/ODIHR, Shkup (+389-2-320 4777);

Z. Jens Eschenbacher, zëdhënësi i OSBE/ODIHR-së (+48-603-683 122); ose z. Dreë Hyslop, Këshilltar për zgjedhje pranë OSCE/ODIHR, në Varshavë (+48-22-520 0600);

Z. Andreas Baker, Këshilltar i kryesisë, Sekretariati ndërkombëtar i AP OSBE, në Kopenhagë (+45 60 10 83 80);

Z. Chemavon Chahbazian, Sekretar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (+33-662265489);

Z. Jean Philippe Bozouls, Kongres i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës (+33672754297)

Adresa e MNVZ e OSBE/ODIHR:

Ul. Makedonija 9-11, kati 2

1000 Shkup

Tel: +389-2-320 4777

Faks: +389-2-320 4773

E-mail: office@odhr.org.mk